



KOMPANIA RAJONALE E UJIT DHE KANALIZIMIT  
"BIFURKACIONI" Sh.A.

# Plani i Biznesit 2016/18

Nentor, 2015



Ferizaj



## PËRMBAJTJA

### Hyrje

|   |    |
|---|----|
| .....   | 3  |
| 1.Historia e Bisnesit .....                                       | 4  |
| 2.Synimet dhe objektivat Strategjike .....                        | 5  |
| 2.1 Faktorët e mbrendshëm - përparësitë dhe dobësitë .....        | 5  |
| 2.2 Faktorët e jashtëm – përparësitë dhe dobësitë .....           | 6  |
| 2.3 Qëllimet strategjike .....                                    | 7  |
| 2.4 Objektivat e punës .....                                      | 7  |
| 3. Shërbimet me konsumatorë .....                                 | 7  |
| 3.1 Parashikimi i kërkesës dhe matjes .....                       | 7  |
| 3.2 Gadishmëria për të paguar .....                               | 8  |
| 3.3 Trendet e kërkesave më të shpeshta të konsumatorëve .....     | 8  |
| 3.4 Kërkësat e performancës së shërbimit ndaj konsumatorëve ..... | 9  |
| 3.5 Ndryshimet potenciale në kufijtë gjeografik .....             | 9  |
| 4. Plan i menaxhimit të asetave .....                             | 9  |
| 4.1 Zhvillimet e personelit .....                                 | 9  |
| 4.2 Nevojat aktuale për personel .....                            | 11 |
| 4.3 Nivelet e aftësisë dhe programet e trajnimit .....            | 11 |
| 4.4 Politika e pagesës (përfitimet ,pagesat nxitëse etj.) .....   | 11 |
| 4.5 Plani i investimeve kapitale .....                            | 12 |
| 4.6 Përshkrimi i artikujve kapital .....                          | 12 |
| 5. Plani operativ .....   | 12 |
| 5.1 Programet operacionale .....                                  | 13 |
| 5.2 Programet e performancës mjedisore .....                      | 13 |
| 5.3 Programet e përgjithme të administratës.....                  | 13 |
| 5.4 programi i marrëdhënëve me konsumatorë .....                  | 14 |
| 6. Plani financiar .....  | 15 |
| 6.1 Plani financiar kapital .....                                 | 16 |
| 7. Plani komercial .....  | 22 |
| 7.1 Rregullimi i lidhjeve ilegale .....                           | 22 |
| 7.2 Përmirësimi i faturimit të bazës së konsumatorëve .....       | 22 |



## Hyrje

Plani i Biznesit për periudhën 2016 – 2018, është përgaditur duke u mbështetur ne performancën dhe zhvillimin e trendit nga viti 2012 deri ne vitin 2015, per 4 vite radhazi. Planifikimin për vitet 2016-2018 eshte hartuar duke u mbështetur në Ligjin për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087, Neni 21.3 mbi zyrtarët e NP-ve dhe Neni 30 mbi Analizimet e Planit afarist, sipas udhëzimeve dhe rekomandimeve të Zyrës Rregullatore për Ujë dhe Kanalizim dhe në përkrahje të plotë nga palët e interesit Komuna e Ferizajit si mbikqyrëse përmes Bordit i Drejtorëve, aksionarëve, konsumatorët etj.

Në këtë plan përshkruhen qëllimet, strategjitë dhe aktivitetet e propozuara duke u mbështetur nga trendi i zhvillimit per 4 vite të Kompanisë që do të synohen të plotësohen dhe qe do te ndërmerren gjatë periudhës 2016-2018.

Plani i biznesit do t'i nënshtrohet rishikimit dhe freskimit së paku në baza vjetore pas aprovimit te ketij planifikimi tre vjeçar dhe sipas performancave te treguar gjate implementimit te tekij planifikimi. Në krahasim me vitet e kaluara ky Plan i Biznesit për vitet 2016-2018 përgatitet për KRU "BIFURKACIONI" SHA cili nga janari i vitit 2015 ka edhe nje njesi me shume. Njësinë e ujësjellësit eshte ajo e komunes se Kaçanikut.

Gjatë periudhës planifikuese 2016-2018 pritet të zgjerohet zona e mbulimit me shërbime. Do të zgjerohet zona e shërbimit në disa lagje të zonës urbane dhe do të kalojnë në menaxhimin e kompanisë disa zona rurale të reja, projektet dhe burimet e të cilave do të i financoj donatori, komuna, kompania dhe konsumatori. Deri në fund të vitit 2018 përqindja e furnizimit me ujë të pijshëm do të jetë mbi 95% apo e planifikuar ne 2018 do te arrije 98%, ndërsa me mbledhjen e ujërave të zeza deri mbi 95%.

Të ardhurat/shpenzimet janë analizuar nga secila qendër e te hyrave/shpenzimeve.

Që të arrijë qëllimet e saja kryesore Kompania planifikon të ngritë të ardhurat e arkëtuara dhe shkallen e inkasimit në 70% deri në 2018. Të ardhurat e krijuara do të mjaftojnë për mbulimin e të gjitha shpenzimeve operative dhe nevojave për investimet e parapara për periudhën planifikuese.

Faturat lëshohen jo për të gjithë konsumatorët e regjistruar, por do të punohet që konsumatorët pasiv të ndahen veçmas nga konsumatorët e regjistruar.

Ekipi menaxhues e kupton vlerën e zhvillimit të aftësive të stafit të kompanisë dhe për këtë qëllim ka identifikuar disa fusha ku duhet të ndërmerren trajnime.

Kompania edhe pas avancimeve ne programe te faturimit dhe te kontabilitetit, edhe më tutje do të avancoj sistemin ekzistues informativ të menaxhmentit.

## 1. HISTORIA E BIZNESIT

Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit 'Bifurkacioni'sh.a., (më tej 'Kompania') është ndërmarrje publike komunale që ofron shërbimet e furnizimit me ujë të pijshëm dhe mbledhje të ujërave të zeza në pjesën jug-lindore të Kosovës në Komunën e Ferizajit. Nga viti 1999 Kompania i është nënshtuar procesit të konsolidimit deri më 31 Qershor 2007 kur është themeluar si shoqëri aksionare nga Qeveria e Kosovës gjegjësisht Ministria për Tregti dhe Industri dhe se aksionar eshte komuna e Ferizajt me 85.30% te kasioneve dhe me 14.70% kumuna e Kaçanikut.



Deri në 31 Qershor 2008 Kompania është mbikëqyrur nga Agjensioni Kosovar i Mirëbesimit, ndërsa pas kësaj date Kompania mbikëqyret nga Komuna e Ferizajit gjegjësisht edhe nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave përmes Administratës Tatimore të Kosovës për obligimet tatimore që lindin nga veprimtaria e kompanisë.

Kompania posedon licencën për kryerjen e veprimtarisë së saj, të lëshuar nga Zyra Rregullatore për Ujë dhe Kanalizim.

Prodhimi dhe shitja e ujit të pijshëm, mbledhja e ujërave të zeza dhe ujërave atmosferike janë aktivitetet kryesore të ndërmarrjes.

Vlerat kryesore të Kompanisë janë përkushtimi për ofrimin e shërbimeve cilësore ndaj konsumatorëve, arritja e vetëqëndrueshmërisë financiare dhe të qenit transparent ndaj akterëve relevant të sektorit të ujit në Kosovë.

## 1.2 .Deklaratat e Politikës

### 1.2.1 Deklarata e “vizionit”

Menagjmenti i KRU “Bifurkacioni” sh.a. i përkrahur nga palët e interesit (Bordi i Drejtorëve-aksionari, ZRRUM-i, donatorët, komuna Ferizaj, institucionet qeveritare, konsumatorët etj) dhe me ndihmën e të gjithë punëmarrësve kanë për motiv furnizimin cilësor dhe sasior me ujë të pijes dhe largimin e ujërave të ndotura.

Ofrimi i shërbimeve kualitative dhe rritja e qëndrueshmërisë financiare është synimi i së tashmes dhe i së ardhmes së kompanisë.

Të vetëdijshëm se në kushtet e tanishme kjo është një gjë e pamundur, do të vihen në dispozicion të gjitha burimet njerëzore dhe burimet financiare që të minimizohen humbjet teknike dhe eliminohen në tërësi humbjet administrative të ujit nga njëra anë dhe të maksimalizojnë të gjitha aktivitetet lidhur me rritjen e shkallës së arkëtimit.

Prandaj ky është prioriteti i parapërcaktuar: Zvogëlimi i sasisë së ujit të pa faturuar si dhe rritja e normës së pagesave të konsumatorëve për shërbimet duke reflektuar në rritjen e qëndrueshmërisë financiare.

Përmes këtyre aktiviteteve në të ardhmen do të krijohen kushte të favorshme për rritjen e nivelit të investimeve nga burimet vetjake.

Përafrimi i përbushjes së një vizioni tillë do të krijonte parakushte më të mira për investime nga donatorët, bankat dhe institucionet tjera financiare.

### 1.2.2 Deklarata e “misionit”

Misioni i KRU “Bifurkacioni” sh.a. i përcaktuar në këtë Plan të Biznesit :

- Furnizimi me ujë të pijes në pajtim me standardet e OBSH-së
- Maksimizimi i kohës së furnizimit,
- Largimi i ujërave të ndotura,
- Mirëmbajtja dhe zgjerimi i rrjetit të ujit të pijshëm
- Mirëmbajtja dhe zgjerimi i rrjetit të ujërave të ndotura

Orientimi i të gjitha aktiviteteve të punës do të kenë të përqëndruar konsumatorin në qendër të vëmendjes. Të gjithë konsumatorët do të kenë trajtim dhe qasje në shërbim:

- Pa diskriminim racor,
- Pa diskriminim në përkatësinë religjioze,
- Pa diskriminim në përkatësinë kombëtare,
- Pa diskriminim në përkatësinë gjinore etj.



Duke përmbushur këtë "mision" do të bëhet e mundur sigurimi vetëqendrushmerine me qëllimin e fundit që të sigurojë shërbime cilësore të ujit të pijshëm në pajtim me standardet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Çasja e afarizmit të kompanisë do të jetë transparente dhe e bazuar në dispozitat ligjore. Kjo do të bëhet në bashkëpunim me palët e interesit:

- Punëmarrësit,
- Komuna Ferizaj permes Bordit te Drejtoreve dhe Komisionit te Aksionareve,
- Komuna Kaçanik permes Bordit te Drejtoreve dhe Komisionit te Aksionareve,
- Ministrinë për Ekonomi dhe Financa,
- Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik,
- Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor,
- Zyrën Rregullative për Ujë dhe Mbeturina
- Konsumatorët ( të organizuar në komisione,shoqata etj).
- Donatorët dhe institucionet financiare

### 1.2.3.Deklarata e riskut ( rreziku )

Përgatitjes së këtij Planit të Biznesit i është qasur nga parimi i vazhdueshmërisë dhe zhvillimi i aktiviteteve biznesore në një periudhë të gjatë kohore. Rreziqet e mundshme në aspektin e parashikimit për periudhën në të cilën bëhet ky plan i biznesit dhe pamundësia e realizimit të tij mund të përmbliidhen në:

- Mungesa eventuale rezervave të ujit (mungesë e reshjeve atmosferike),
- Ngritja e koston së jetesës (rritja e tarifës së energjia elektrike,karburanteve,pjesëve të ndërrimit etj),
- Lëvizjet sociale,
- Krizat politike
- Forcat tjera madhore (tërmeti,vërshimet,zjarret etj)

### 1.2.4. Deklarata e Tarifave të shërbimit

Kompania Rajonale e Ujësjellësi "Bifurkacioni" sh.a. do të zbatojë tarifën që vendosë Zyra Rregullative për Ujë dhe Mbeturina si autoritet kompetent në bazë të Ligjit mbi Veprimtarinë e Ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit kanalizimit dhe të mbeturinave (Ligji Nr. 03/L-086)..

Në bazë të tarifës aktuale (duke marrë në konsideratë edhe shkallën e arkëtimit dhe nivelin e humbjeve teknike dhe komerciale) mund të bëhet vetëm mbulimi i kostove operative por jo edhe kostove të mirëmbajtjes dhe investimeve kapitale. Kjo nënkupton se tarifat ekzistuese nuk garantojnë investime më të mëdha drejt përmirësimit të bazës materiale dhe për shërbime më të mira për konsumatorët pa ndihmen e fondeve tjera siq jane donacionet.

Zbatimi i tarifës së miratuar në ciklin tarifar 2015-2016 por pa mos llogaritur as korrixhimin e tarifës (rritjes) në ciklin e ardhshëm tarifar do te jete i domosdoshem edhe për shkak të:

- Rritjes së kërkesës për të financuar planin e investimeve kapitale nga fondet e brendshme të kompanisë,
- Rritjes së çmimit të energjisë elektrike,
- Rritjen e çmimit të ujit të papërpunuar ,
- Rritjen e çmimit të karburanteve,
- Rritja e vlerës së shërbimeve nga palët e treta.



Prandaj zbatimi i tarifës do të ndikojë pozitivisht dhe do të mobilizojë menagjmentin dhe personelin tjetër në KRU "Bifurkacioni" sh.a. në përmbushjen me sukses të misionit të përcaktuar.

Korrixihi-rritja e tarifës konsiderojmë se do të ketë efektin në stimulimin e kursimit të ujit në dobi të konsumatorit nga njëra anë (direkt) dhe nga ana tjetër do të ketë përfitime indirekte përmes kthimit të të njëjtës në shërbime më të mira.

Rritja e tarifave e kombinuara edhe me aktivitetet për zvogëlimin e humbjeve teknike dhe komerciale nga njëra anë si dhe rritjes së shkallës së arkëtimit nga ana tjetër në bazë të treguesve deri në vitin 2018 do të krijoreshin mundësi financiare që Kompania të jetë në gjendje që pa vështirësi të mëdha për investime dhe pa vënë në pyetje financimin e shpenzimeve tjera operative.

Prioriteti i shfrytëzimit të këtyre investimeve janë të dedikuara në radhë të parë në zvoglimin e humbjeve teknike dhe humbjeve administrative të ujit si dhe përmbushjen cilësore të kërkesave të konsumatorëve.

### **1.3. Zona e shërbimit dhe organizimi i Kompanisë**

#### **1.3.1. Zona e shërbimit**

Kompania Rajonale e Ujësjetësimit (KRU) "BIFURKACIONI" sh.a. shërbimet e veta i ofron në pjesën jugore të Kosovës duke i përfshirë këto komuna:

- a) Ferizaj dhe
- b) Kaçanik

Kompania operon në gjithë zonën urbane të dy komunave, gjegjësisht në qytetin e Ferizajit dhe atë të Kaçanikut, si kompani ka në menaxhim edhe zonat rurale. KRU "Bifurkacioni" sh.a. posedon një fabrikë për trajtimin e ujit të vendosur në fshatin Pleshin. Në këtë fabrikë uji fillestar merret nga lumenjtë që janë kater, **Lumin Madhe, Lumi Vogel, Prroni Pykes dhe Prroni Syles**. Gjithashtu posedojmë 4 burime që furnizojnë komunën e Kaçanikut, këto burime janë **Burimi 1 në Ivaj, Burimi 2 po ashtu në Ivaj, Burimi Kafegji në Lupeten dhe Burimi Bardh**.

#### **1.3.2. Sistemet e ujesjetësimit në zonat rurale në njesinë Ferizaj dhe Kaçanik**

Në kuadër të sistemit të furnizimit me ujë të pijes dhe largimit të ujërave të zeza bëjnë pjesë edhe stacionet e pompave, depozitë e ujit-rezervuarët dhe rrjeti primar dhe ai shpërndarës i ujit të pijes dhe rrjeti primar dhe rrjeti sekondar i kanalizimeve.

##### **1. Sistemi i ujesjetësimit fsh. Mirash furnizon:**

- a) Mirash i ri
- b) Mirash i vjetër

##### **2. Sistemi i ujesjetësimit fsh. Cernille furnizon:**

- a) Fsh. Cernille

##### **3. Sistemi i ujesjetësimit fsh. Bablak furnizon:**

- a) Fsh. Bablak

##### **4. Sistemi i ujesjetësimit Kosinë –Muhoc furnizon:**

- a) Ternn
- b) Lubovc
- c) Koshare
- d) Slivove
- e) Lloshkobare



- f) LLojza
- g) Kosine
- h) Bublic
- i) Saraishte
- j) Muhoc
- k) Kompleksi As Petrol

**5. Sistemi i ujesjellesit fsh. Dremjak furnizon:**

- a) Fsh. Dremjak

**6. Sistemi i ujesjellesit fsh. Varosh furnizon:**

- a) Fsh. Varosh
- b) Gjysme e fsh. Nikadin

**7. Sistemi i ujesjellesit fsh. Gurez furnizon:**

- a) Fsh. Komogllave
- b) Fsh Gurez

**8. Sistemi i ujesjellesit fsh. Talinoc furnizon:**

- a) Fsh. Talinoc
- b) Zonen e Hib Petrolit

**9. Sistemi i ujesjellesit fsh. Softaj furnizon:**

- a) Softaj
- b) Pojate
- c) Papaz
- d) Sazli

**10. Sistemi i ujesjellesit fsh. Mirosale furnizon:**

- a) Fsh. Mirosale
- b) Fsh. Rahovice

**11. Sistemi i ujesjellesit fsh. Begrac furnizon:**

- a) Fsh. Kaçanik i Vjeter
- b) Begrac

Zgjerimi sistemiteve për vitin 2016 do të bëhet edhe për tri sisteme të reja me gjithsej 5 fshatra që në total do të jenë me 1700 konsumator të ri. Këto sisteme janë:

**12. Sistemi i Ujesjellesit për fshatrat Prelez i Muhaxhereve dhe i Jerlive**

- a. Prelez i Muhaxhereve
- b. Prelez i Jerlive

**13. Sistemi i Ujesjellesit Greme**

- a. Fshati Greme
- b. Fshati Rakaj

**14. Sistemi i ujesjellesit Gllobocic**

- a. Fshati Gllobocice

Totali i sistemeve në zonat rurale në vitin 2016 do të bëhen në 14 sisteme me gjithsej 35 fshatra ku prej këtyre 5 fshatra veq janë që do të fillojnë të regjistrohen konsumatorët në vitin 2016.

Në kuadër të sistemit të furnizimit me ujë të pijes dhe largimit të ujërave të zeza bëjnë pjesë edhe stacionet e pompave, depozitë e ujit-rezervuarët dhe rrjeti primar dhe ai shpërndarës i ujit të pijes dhe rrjeti primar dhe rrjeti sekondar i kanalizimeve.



- 14 stacione pompash,
- Depozite (rezervuar) me vëllim  $V = 5,000 M^3$  ne Fabriken e prodhimit te ujit ne fshatin Pleshin dhe zotat rurale ne vellim prej  $V = 6,000 M^3$
- Burime ne komunen e Kaçanikut me nje kapacitet te furizimit prej  $V = 4,000.00 M^3$
- 227 km gypa uji te pijes primare dhe sekondar, ne zonen urbane dhe ne zonen rurale
- 222 km kolektor kryesor kanalizimi dhe rrjete shpërndarës, ne zonen urbane dhe ne zonen rurale

### 1.3.3. Struktura organizative

KRU "BIFURKACIONI" sh.a. është kompani publike e korporatizuar. Si shoqëri aksionare operon prej 01/07/2007.

Pas shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës ( 17.02.2008 ) përkatësisht hyrjes së fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ( 15.06.2008 ) është miratuar Ligji mbi Ndërmarrjet Publike (Ligji Nr. 03/L-087). Mbi bazën e këtij Ligji komuna e Ferizaj dhe ajo e Kaçanikut jane pronare te vetme e të gjitha akcioneve të kompanisë.

Komisioni i aksionareve në emër të pronarit të akcioneve e ushtron kompetencën dhe përgjegjësinë në bazë të Ligjit, Statutit dhe akteve tjera nënligjore.

Ky ushtrim i kompetencës dhe përgjegjësisë realizohet nëpërmjet Bordit të Drejtorëve.

Pronari në përfundim të vitit 2014 ka përfunduar aktivitetet për zgjedhjen e Bordit të Drejtorëve.

Kryeshefi Ekzekutiv është anëtar i barabartë me të zgjedhurit tjerë në Bordin e Drejtorëve të KRU "BIFURKACIONI" sh.a

### 1.3.4. Struktura menaxhuese

Kompania udhëhiqet nga Kryeshefi Ekzekutiv në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me Zyrtarin Kryesor Financiar dhe të Thesarit që udhëheq Drejtorine per Financa dhe menaxherin e departamentit operativ, menaxherin e shitjes, menaxherin e prodhimit, menaxherin e shërbimit me kosnumator.

Kompania ka te organizuar edhe zyren e auditimit te brendeshem që udhëheq zyrtari i auditimit, sekretarin e Bordit të Drejtorëve dhe zyren e Prokurimeve.

Struktura organizative në pajtim me statutin aktual dhe njëjta e emërtuar përmes pozitave dhe bartësve të tyre mund të shikohet në skemën organizative të kompanisë të prezantuar më poshtë.

Skema organizative është miratuar nga ana e Bordit të Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur më 31/07/2015. Skema të mund të ndryshojë vetëm në rast të ndryshimeve të domosdoshme që mund të bëjë aksionari (Komuna e Ferizaj dhe ajo e Kaçanikut).





## 2. SYNIMET DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Vizioni i Kompanisë është fokusimi në cilesin dhe sasine e shërbimit të ofruar për konsumatorët – qytetarët e qe konsumatorët - qytetarët presin nga ne si kompani një stabilitet në furnizim me ujë dhe një shërbim për menaxhimin e ujerave të zeza me një perkushtim maksimal, krejt kjo duke aluduar në rendesin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe me menaxhimin e ujërave të zeza. Është një vizion ambicioz dhe afatgjatë por që e mbanë Kompaninë të fokusuar në furnizimin me ujë të pijshëm dhe me menaxhim të ujërave të zeza për 24 orë, çdo ditë mbrenda vitit.

Misioni i përgjithshëm i Kompanisë është që të siguroj ujë të pijshëm, cilësor dhe të mjaftueshëm për të gjithë konsumatorët e saj pa dallim race, gjinie dhe religjioni.

Kompania poashtu ju ofron konsumatorëve të vetë shërbimin e mbledhjes dhe largimit të ujërave të zeza. Kompania angazhohet në zgjerimin e rrjetit të furnizimit me ujë dhe mbledhjes së ujërave të zeza dhe eventualisht shikimin e mundësisë së ndërtimit të fabrikës së përpunimit të ujërave të zeza përmes burimeve të jashtme të financimit.

Kompania angazhohet me gjithë potencialin që ka në përdorim në shfrytëzimin racional të burimeve të ujit dhe në mirëmbajtjen e rregullt të rrjetit të ujit dhe ujërave të zeza.

Kompania është përfundimisht e orientuar në plotësimin dhe kënaqjen e kërkesave të konsumatorëve të saj, përkundër natyrës monopolistike të biznesit të saj, si dhe sigurimin e transparencës dhe bashkëpunimit me të gjithë akterët e sektorit të ujit në Kosovë dhe më gjerë.

Implementimi i misionit të Kompanisë mund të përcillet me rreziqet eventuale të natyrave të ndryshme si:

- Mungesa e ujit në burime si pasojë e mungesës së reshjeve atmosferike
- Kriza sociale-ekonomike në nivel të vendit ose lokal me ndikim në mosrealizimin e të ardhurave të gatshme
- Rastet e Fatekeqesive natyrore që nuk varen nga ne si kompani.

### 2.1 Faktorët e brendshëm – përparsitë dhe dobësitë

- Përparsitë :

- FPU me aparaturë shumë moderne dhe Menaxhimi elektronik i prodhimit të ujit.
- Saktësia e leximit të ujëmatësve
- Faturimi dhe dërgimi i faturës në kohën e duhur
- Zyra me mardhenie me konsumator efikase
- Sanimi i difekteve në kohë dhe kualitet
- Kooperimi i menaxhmentit
- Detektimi i humbjeve
- Aplikacioni bashkohor për Financa, Faturim, Kujdesit për Konsumator, Burimet Njerezore, Pagat, GIS i planifikuar për impementim.
- Mapp-ingu-udhërrëfyes i investimeve kapitale, etj.

- Dobësit

- Pamundesia për të percjell të gjitha keqperdorimet e mundshme,
- Faturimet paushalle dhe faturimet e dyfishta që ndikojn në rritjen e keqperformances,
- Amortizimi i paisjeve
- Vjetërsia e rrjetit të ujësjellësit
- Vjetërsia e rrjetit të kanalizimit dhe mungesa e impiantëve
- Mungesa e kuadrave profesionale.



## 2.2 Faktorët e jashtëm - përparësitë dhe dobësitë

- *Mundësit:*
  - Investimet kapitale nga Donatorët
  - Përkrahja nga Kuvendi Komunal në investimet kapitale në rrjetë të ujësjellësit dhe kanalizimit.
  - Përkrahja me grante nga MEF
  - Përkrahje nga ZRRUK
  
- *Rreziqet:*
  - Mos funksionimi i Gjyqësorit
  - Rastet Sociale
  - Minoritetet
  - Kriza sociale-ekonomike (Standardi i ulët i jetesës)
  - Vetëdijësimi jo i mjaftueshëm i qytetarëve
  - Mungesa burimeve të bollshme të ujit
  - Energjija elektrike jo stabile dhe çmim të lartë
  -

## 2.3 Qëllimet strategjike

Si qëllime strategjike kompanija vlerëson keto:

- Rritjen e kohëzgjatjes së furnizimit me ujë të konsumatorëve ekzistues dhe atyre të ri.
- Kontinuiteti i kualitetit të ujit të pijshëm në pajtim me standardet e IKSHP
- Arritjen e vetëqëndrueshmërisë financiare
- Promovimin e relacioneve të mira me konsumatorë.
- Adoptimin e politikave tarifore të ZRRUK për arritjen e të ardhurave të mjaftueshme që do të mund të mbulojnë shpenzimet operative dhe investimet e domosdomshme.
- Sigurimin e shfrytëzimit racional të burimeve të ujit.
- Krijimin e një ambienti të favorshëm të punës.
- Punesimi i kuadrave profesionale.

Për realizimin e qëllimeve kryesore strategjike, deri në vitin 2018 Kompania do të arrijë përmes këtyre objektivave:

- Zvogëlimin e ujit të pafaturuar në **43%**
- Rritjen vazhdueshme të furnizimit me ujë të pijshëm deri në **24 me 0.**
- Rritjen e propocionit të konsumatorëve me ujëmatës në **96%**
- Rritjen e shkallës së arkëtimit në **70%**
- Ngritjen e normës së mbulesës së punës në **1.48**
- Përqindjen e konsumit të matur **95%**
- Rritjen e efikasitetit të stafit në **6.85**




## 2.4 Objektivat e punës

Duke u bazuar në specifikat e kompanisë sonë (burimet ujore jo të mjaftueshme, nevojat për përfshirjen nën menaxhimin e kompanisë të zonave rurale dhe shtrirjes së rrjetit në disa pjesë të qytetit të Ferizaj dhe të Kaçanikut) janë planifikuar objektivat të cilat janë paraqitur si më poshtë.

Tab 1 Objektivat e performances

| Teguesit Kryesor te Performance         | Njesia    | Realizimet nga viti 2012 - 2015 |              |              |              | ndi I Planifikimit sipas Trendit te Realizimit - 2016-2018 |              |              |
|---|-----------|---------------------------------|--------------|--------------|--------------|--|--------------|--------------|
|   |           | 2012                            | 2013         | 2014         | 2015         | 2016   | 2017         | 2018         |
| Uji I Prodhuar                          | m3        | 7,071,431                       | 7,143,479    | 6,324,973    | 7,601,953    | 8,349,617  | 8,600,105.81 | 8,944,110    |
| Uji I Faturuar                          | m3        | 2,539,217                       | 2,898,847    | 2,992,985    | 3,612,300    | 4,081,899  | 4,490,089    | 4,849,296    |
| Uji I pafaturuar si perqindje - Humbjet | %         | 64%                             | 59%          | 53%          | 52%          | 51%  | 48%          | 46%          |
| Numri I Konsumatoreve te Regjistrusur   | numer     | 17,711                          | 22,124       | 23,600       | 25,080       | 26,910   | 28,410       | 29,210       |
| Uji I faturuar per lidhje               | m3/lidhje | 143                             | 131          | 127          | 144          | 152  | 158          | 166          |
| Faturimi ne EUR                         | EUR       | 1,585,675.14                    | 1,795,000.13 | 1,748,452.15 | 1,933,769.92 | 2,254,396.67   | 2,365,029.10 | 2,504,350.81 |
| Inkasimi ne EUR                         | EUR       | 929,268.51                      | 1,041,500.07 | 1,114,393.23 | 1,227,558.02 | 1,489,893.18   | 1,616,432.06 | 1,745,746.62 |
| Norma e arketimit - e pergjithshme      | %         | 59%                             | 58%          | 64%          | 63%          | 66%  | 68%          | 70%          |
| Staf per 1000 konsumator                | numer     | 6.15                            | 5.20         | 5.85         | 7.06         | 6.87   | 6.86         | 6.85         |
| Numri I Punetoreve                      | numer     | 109                             | 115          | 138          | 177          | 185  | 195          | 200          |

Fig. Nr. 1 – Paraqitja ne menyrr grafike e ujit te prodhuar dhe ujit te faturuar. Realizimi 2012-2015 dhe planifikimi 2016-2018.



## 3. SHËRBIMET PËR KONSUMATORË

### 3.1 Parashikimi i kërkesës, dhe parashikimet e matjes

Parashikimi i kërkesës për ujë për vitet e planifikuara do të jetë i bazuar në zvogëlimin e humbjeve, rritjen e numrit të ri të konsumatorëve, konvertimin e lidhjeve të paligjësme, konvertimi i konsumatorëve të pa matur në të matur.




### 3.2 Gatishmëria për të paguar

Kompania bënë arkëtim në tre kategori të konsumatorëve Amvisëri, Biznese dhe Institucione. Ne planifikojmë se në vitin 2016 kategoria e amvisëris do të ket një rritje te arkëtimit ne 66% nga që do të ketë një intensitet të shtuar të ekipeve në teren dhe një angazhim të vecant i zyrës së mardhënieve me konsumator ku do të organizoj takime të vazhdueshme ne terren (face2face), po në këtë vit do të subvencionim nga qevereia një pjesë e konsiderueshëm e konsumatorëve të cilët janë raste sociale ndërsa kategoria e bizneseve poashtu do të arrijë këtë normë të inkasimit nga që ka filluar vetëdijësimi i kësaj kategorie që edhe shërbimet tona janë një produkt i cili duhet të paguhet si dhe angazhimi i ekipit të shkyqjeve, në institucione planifikojm që ta kemi po të njëjtën përqindje nga që janë zotuar që të bëjnë një planifikim më të mirë të buxhetit të tyre për periudhen 2016-2018.

**Tabela nr. 2 - Raporti I Faturimit ne EUR dhe Inkasimit ne EUR per periudhen 2012-2015 dhe 2016-2018 e planifikuar**

| Te Dhenat                                   | 2012         | 2013         | 2014         | 2015         | 2016         | 2017         | 2018         |
|---|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|
| Faturimi ne EUR                             | 1,585,675.14 | 1,795,000.13 | 1,748,452.15 | 1,933,769.92 | 2,254,396.67 | 2,365,029.10 | 2,504,350.81 |
| Inkasimi ne EUR                             | 929,268.51   | 1,041,500.07 | 1,114,393.23 | 1,227,558.02 | 1,489,893.18 | 1,616,432.06 | 1,745,746.62 |
| % e Planifikuar                             | 59%          | 58%          | 64%          | 63%          | 66%          | 68%          | 70%          |
| rrqindja e Faturimit - Rritjet gjate viteve |              | 12%          | -3%          | 15%          | 14%          | 5%           | 6%           |
| rrqindja e Inkasimit - Rritjet gjat viteve  |              | 11%          | 7%           | 11%          | 21%          | 12%          | 11%          |

**Fig 2. Grafiku i Faturimit dhe inkasimit per perudhen 2012 -2015 Realizimi dhe 2016-2018 planifikimi.**



Grafiku me lart paraqet vitin baze si vit te fillimit te trendit dhe ai eshte viti 2012 duke vazhduar vitet 2013, 2014 dhe 2015 si vite qe jane realizuar faturimet dhe inkasimet, ndersa vitet qe dallohen edhe me ngjyra, gjegjesisht vitet 2016-2018 jane vitet e plafikimit. Siq shihet nga grafiku kemi rritje te vazhdueshme dhe percjellja e trendit drejt rritjes si te faturim po ashtu edhe te inkasimit. Tabela me lart tregon neqj proporcion me ta marr te rritjes se inkasimit ne raport me faturimin, ku tregohet



perkushtimi me i lart i stafit per rritjen e te hyrave nga faturimet e ujit dhe njeherit edhe realizimin e e planifikimit per vjeljen e te hyrave nga shitja – faturimi i ujit. Ngritja me e lart e inkasimit se sa faturimit tregon qe kompania eshte e angazhuar seriozist ne inkasimin edhe te borxheve te vjetra dhe vjeljen e tyre ne nej shkall me te knaqshme nga vitet baze te realizimit.

### **3.3 Trendet e kërkesave më të shpeshta të konsumatorëve**

Trendet e kërkesave më të shpeshta të konsumatorëve janë të bazuar në bazë të kategorive të cilat edhe i faturojmë ne. Kërkesat më të shumta paraqiten nga kategoria e amvisërive ku relativesht kërkesat e tyre janë shlyerja e borxheve të vjetra, faturimi i lartë për ujin e shpenzuar (nga që kan rrjedhej brenda objekteve), tek bizneset është kërkes e natyrës tjetër të cilët sistematikisht ankohen për tax-en fikse për rrjet të cilët aludojnë se është shumë e lartë, kërkes tjetër që vie nga institucionet është që ti bëhet faturimi në bazë të leximit ku ne si objektiv në çerekun e parë të vitit 2013 do të implementojmë vendosjen e të gjitha ujëmatësve.

### **3.4 Kërkesat e performancës së shërbimit ndaj konsumatorëve**

Furnizim 24orë më ujë dhe shtypje stabile është një breng për ne, nga se furnisohemi me uje prej burimeve sipërfaqesore pa ndonje akumulacion ku kjo varet nga te reshurat atmosferike ne te kunderten sa i perkete mundesive tona ne jemi duge vazhduar ne eliminimin e kycjeve ilegale, bypasseve konsumatoreve te pa regjistruar, ndërsa sa i përket kërkesave tjera të gjithat realizohen në kohë rekorde.

## **4. PLANI I MENAXHIMIT TË ASETEVE**

Në fillimin e vitit 2016 zyrtari për asete në bashkëpunim me departamentet tjera do të bëjë verifikimin dhe paisjen me numër identifikues për inventar njëkohësisht do të bëhër rifreskimi i të dhënave në gjithë sistemin e asetëve dhe të verifikohen mangësit e mundëshme. Fillimi i vitit 2016 eshte nje perparesi se asetet jane te regjistruara ne programin e kontabilitetit dhe menaxhimi i tyre eshte shume me i sakt, efikas i shpejt dhe llogaritja e amortizimit dhe rifreskimi jane te lidhura ne menyre automatike me kontabilitet qe deri me tani nuk ka qene e mundur te lidhet aplikacioni i asetëve me bazen e kontabilitetit.

### **4.1 Zhvillimet e Personelit**

Gjatë fillimit të vitit 2008 është themeluar Kuvendi i Aksionarëve. Bordi i Drejtorëve i përbër nga Drejtorët Jo-ekzekutiv (të jashtëm) dhe Drejtori Ekzekutiv (Kryeshefi Ekzekutiv i Kompanisë). Kryeshefi Ekzekutiv do të jetë përgjegjës për menaxhimin dhe operimin e Kompanisë. Ai do të ketë kompetencat të lidhë kontrata në emër të kompanisë, në përputhje me statutin dhe Ligjin e Zbatueshëm. Kryeshefi Ekzekutiv do të ketë kompetencën të punësojë dhe shkarkojë zyrtarët e Kompanisë dhe të delegojë këtë kompetencë zyrtarëve të tjerë dhe anëtarëve të personelit. Kryeshefi Ekzekutiv do të duhet të i kryejë të gjitha detyrat tjera që i janë caktuar sipas kontratës së punës. Vlerësimi i performancës së Kryeshefi Ekzekutiv do të bëhet nga Bordi i Dejtoreve. Menaxheri i Financave do të jetë përgjegjës për të gjitha aktivitetet financiare në Kompani si: (i) mbajtja e llogarive të Kompanisë, (ii) menaxhimi i financave sipas nevojës së Kompanisë, (iii) raportimi te akterët relevant dhe (iv) përgjegjësia e përgatitjes së planit të biznesit, raportet financiare periodike dhe vjetore, perpilimi I deklarateve tatimore mujore, tremujore dhe vjetore.



Kompania rajonale për ujë dhe kanalizim  
" BIFRUKACIONI " SH.A. Ferizaj

Menaxheri i Operativës do të jetë përgjegjës për (i) aktivitetet e prodhimit dhe shpërndarjes së ujit, (ii) mirëmbajtjen e rrjetit dhe (iii) menaxhimin e punëve teknike në teren, menaxhimin e autoparkut dhe sigurimi I atumjeteve per nevojat e kompanise.

Menaxheri i Shitjes do te jete pergjegjes per (i) përgatitjen dhe shpërndarjen e faturave, (ii) menaxhimin e arkëtimit të parave të gatshme, (iii) menaxhimin e ekipit të çkyqjes dhe percjelles se realizimit te planeve afatshkurta dhe afatmesme, raportet periudite dhe vjetore si dhe angazhimi ne rritjen e performances se kompanise.

Menaxheri i Shërbimit me Konsumatorë do të jetë përgjegjës për (i) menaxhimi dhe rexhistrimi I aknesave te konsumatoreve, (ii) menaxhimi i arkave, (iii) raportet periudike dhe arritja e planifikimeve si dhe permbushja e objektiveve, dhe (iv) menaxhimin e relacioneve me konsumatorë.

Gjatë periudhës planifikuese 2016-2018 struktura organizative e Kompanisë do të jetë si në vijim:



#### 4.2 Nevojat aktuale për personel

Në periudhën 2016 Kompania planifikon të rekrutoj 8 punëtorë me qëllim të realizimit të caqeve të parashtruara për të njëjtën periudhë. Struktura profesionale e stafit të ri do të jetë si në vijim:

- Ujëinstalues (2 person),
- Punëtorë për zonat rurale (3 persona)
- Ekspert për GIS (1 Persona)
- Operativ (2 Persona)

Kryerja e detyrave të punës nga secili i punësuar do të bëhet në bazë të përshkrimit detaj të secilit vend të punës veç e veç. Në bazë të këtij përshkrimi janë të përcaktuara kushtet minimale të përgatitjes profesionale, përvojës në punë dhe shkathtësive të tjera si dhe hierarkia e dhënies së përgjegjësisë.

Kompania tenton që gjatë periudhës së planifikuar 2016-2018 të ngrit efikasitetin e stafit. Deri në 2016 Treguesi i Efikasitetit të stafit (numri i të punësuarve për 1000 konsumatorë) pritet të jetë 6.85. Shih tabelen me posht dhe grafikun që prezenton ecurin e numrit të konsumatorëve në raport me numrin e punëtorëve.

**Tabela nr. 3 – Numri i punëtorëve për 1000 konsumator.**

|                                      |       |        |        |        |        |        |        |        |
|--------------------------------------|-------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|
| Numri I Konsumatorëve të Regjistruar | numer | 17,711 | 22,124 | 23,600 | 25,080 | 26,910 | 28,410 | 29,210 |
| Staf për 1000 konsumator             | numer | 6.15   | 5.20   | 5.85   | 7.06   | 6.87   | 6.86   | 6.85   |
| Numri I Punëtorëve                   | numer | 109    | 115    | 138    | 177    | 185    | 195    | 200    |

**Fig. nr. 3 – Paraqitja e rritjes së numrit të konsumatorëve në raport me numrin e punëtorëve, raporti është numri I konsumatorëve perpjestu me numrin e punëtorëve. Standarti është 6 punëtor për 1000 konsumator.**



Personeli i që kryen punët dhe detyrat në KRU "BIFURKACIONI" sh.a. është heterogjen:

- Nga aspekti i përgatitjes profesionale;
- Nga aspekti i shkathtësive, produktivitetit dhe efikasitetit në punë;
- Nga aspekti i përfaqësimit nacional;
- Nga aspekti i përfaqësimit gjinor;



- Nga aspekti i përfaqësimit fetar;
- Nga aspekti social etj.

Kompensimi i pagës për punën për të gjithë personelin konsiderojmë se iu është qasur në mënyrë komplekse dhe gjithëpërfshirëse. Të gjithë të punësuarit përveç pagës bazë iu kompensohet edhe bonusi për ushqimin ditor si dhe bonusi për punë të suksesshme.

Në kategorinë e shpenzimeve të personelit gjatë vitit 2015 pritet të shpenzohen 1,030,600.00 EUR ndërsa në vitin 2016 vlera e planifikuar e kësaj kategorie të shpenzimeve pritet të jetë 1,076,137.93 EUR

Vlera e planifikuar për shpenzimet e personelit në vitin 2016 në krahasim me vitin paraprak janë përafërsisht për 5 % më të larta.

Kjo rritje veq tjerash do të reflektojë si rritjen totale e arkëtimeve për pagesën e pagave më të larta për inkasantët që do të realizojnë shkallën më të lartë të arkëtimeve gjatë vitit 2016 në krahasim me vitin 2015.

Gjatë vitit 2016 është i domosdoshëm rishikimi i nivelit të pagesës për nivelin profesional duke përfshirë menagjmentin e lartë (në shkëmbim të përmbushjes së performancave) dhe personelit tjetër teknik. Sidomos duhet dhënë prioritet vendeve të punës në të cilët është rritë vëllimi i punëve si rezultat i zgjerimit të zonës së shërbimit.

Rritja vjetore e shpenzimeve të personelit me rreth 5 % të vlerës totale prej për vitin e parë si shkallën e njejtë të rritjes në vitet vijuese (gjatë periudhës 2017-2018) mundëson që në mënyrë solide të realizohet një pagesë dhe fonde të mjaftueshme sipas këtij Plani.

Përmbushja-realizimi i treguesve bazik financiar dhe teknik të përcaktuar me këtë Plan të biznesit mund të hapë rrugën (pasi të jetë marrë vendimi kompetent i Bordit të Drejtorëve në procedurë legale dhe transparente) për pagesën e bonuseve-shtesave.

Gjithashtu edhe trajnimit të vazhdueshëm të stafit do ti kushtohet një kujdes i veçantë ndërsa kosto e këtyre është paraqitur në buxhetin e përgjithshëm në kategorinë e shpenzimeve të personeli

#### **4.3 Nivelet e aftësisë dhe programet e trajnimit**

Ekipi menaxhues, duke u bazuar në vlerësimin e kryer në 2014-2015 për identifikimin e nivelit të aftësive të stafit dhe me qëllim të ngritjes së këtij niveli, planifikon që gjatë periudhës 2016-2018 të realizoj trajnimet si në vijim:

- 1) Menaxhmenti i Lartë do të pranoj trajnime nga projekti i ZRRUK-it në lidhje me metodat efikase të menaxhimit të kompanisë.
- 2) Staf i larte dhe i mesem do të trajnohet në modulet e reja të sistemit informativ të menaxhmentit. Trajnimi pritet të realizohet gjatë vitit 2016.
- 3) Ekipi i hartave do të pranojë trajnime në punën me GIS.

#### **4.4 Politika e pagesës (përfitimet, pagesat nxënëse, etj.)**

Gjatë periudhës planifikuese 2016-2018 nuk parashihet ndonjë ndryshim sa i përket kategorizimit të kompenzimit të stafit. Pagat e personelit janë parashikuar që të kenë një rritje të lehtë 3%-5 % me shume se sa inflacioni në vend. Rritja e koeficientit të pagesës në vitin 2013 është rritur për 4.50 EUR, nga 52.50 EUR është ngritur në 57.00 EUR.

Në përgjithësi të gjitha kontratat do të rishikohen çdo 36 muaj. Punetoret që kanë 10 e më shumë vjet pune në kuader të kompanisë BIFURKACIONI, do të leshohen kontrata të përhershme sipas ligjit të punës në fuqi, Ligji 03L / 212 I Republikës së Kosovës.





#### 4.5 Plani i Investimeve Kapitale

Përpilimi i planit për investimet kapitale është bazuar në shumë faktorë ndikues në nivelin e shërbimit cilësor që ka si obligim kompania ndaj konsumatorit. Ndër faktorët që ka përdorur sektori i planifikimit - zhvillimit për caktimin e prioriteteve janë:

- Vjetërsia e gypave
- Numri i madh i defekteve në zonat e caktuara
- Diametri jo i mjaftueshëm i gypave
- Vlerësimi i aftësive dhe efikasiteti i stafit
- Vlerësimi i kushteve të punës

#### 4.6 Përshkrimi i artikujve kapital

- Investimet kapitale në infrastruktur
- investimet kapitale në jo infrastrukturë

Kjo vlenë për investimet kapitale në ujë dhe kanalizim.

**Tab 3 dhe 4 Vlera e investimeve kapitale në infrastrukturë-ujësjellës dhe kanalizim (vetanake dhe donatorët 2016-2018)**

| <b>Investimet kapitale ne rrjetin e ujesjellesit dhe kanalizimit nga investimet vetanake dhe nga donacionet per periudhen 2016 - 2018</b> |  |  |   |  |   |                              |
|---|--|--|---|--|---|------------------------------|
|   | Investimet kapitale ne infrastrukturën e ujesjellesit - Vetanake | Investimet Kapitale ne infrastruktur ujesjelles - Vetanake | Investimet kapitale ne infrastruktur - Kanalizim - Vetanake | Investimet ne joinfrastruktur e kanalizim - Vetanake | Investimet kapitale te perbashketa - Vetanake | <b>Totali ne 2016 - 2018</b> |
| 2016  | 240,000.00   | 55,000.00  | 4,000.00  | 1,500.00   | 100,000.00                                    | 400,500.00                   |
| 2017  | 60,000.00  | 120,000.00   | 5,000.00  | 50,000.00  | 55,000.00                                     | 290,000.00                   |
| 2018  | 180,000.00   | 225,000.00   | 5,500.00  | 2,500.00   | 45,000.00                                     | 458,000.00                   |
|   | <b>480,000.00</b>  | <b>400,000.00</b>  | <b>14,500.00</b>  | <b>54,000.00</b>                                     | <b>200,000.00</b>                             | <b>1,154,500.00</b>          |
|   | Investimet kapitale ne infrastrukturën e ujesjellesit - Dinacion | Investimet Kapitale ne infrastruktur ujesjelles - Donacion | Investimet kapitale ne infrastruktur - Kanalizim - Donacion | Investimet ne joinfrastruktur e kanalizim - Donacion | Investimet kapitale te perbashketa - Donacion | <b>Totali ne 2016-2018</b>   |
| 2016  | 2,867,157.00   | 151,179.00   | 200,000.00  | 8,500.00   | 85,978.00                                     | 3,312,814.00                 |
| 2017  | 180,000.00   | 500,000.00   | 200,000.00  | 7,000.00   | 80,000.00                                     | 967,000.00                   |
| 2018  | 120,000.00   | 400,000.00   | 300,000.00  | 6,000.00   | 75,000.00                                     | 901,000.00                   |
|   | <b>3,167,157.00</b>  | <b>1,051,179.00</b>  | <b>700,000.00</b>   | <b>21,500.00</b>                                     | <b>240,978.00</b>                             | <b>5,180,814.00</b>          |
| <b>Investimet kapitale ne rrjetin e ujesjellesit dhe kanalizimit nga investimet vetanake dhe nga donacionet per periudhen 2016 - 2018</b> |  |  |   |  |   |                              |
| Totali I Investimeve kapitale vetanake ne ujesjelles  |  |  |   |  |   | <b>880,000.00</b>            |
| Totali I investimeve kapitale vetanake ne kanalizim   |  |  |   |  |   | <b>68,500.00</b>             |
| Toali I investimeve kapitale nga donacionet ne rrjetin e ujesjellsit  |  |  |   |  |   | <b>4,218,336.00</b>          |
| Totali I investimeve kapitale nga donacionet ne rrjetine kanalizimit  |  |  |   |  |   | <b>721,500.00</b>            |
| Totali I Investimeve kapitale te perbashkta vetanake dhe nga donacionet ne ujesjells dhe kanalizim  |  |  |   |  |   | <b>440,978.00</b>            |
| <b>Totali I Pergjitheshem</b>   |  |  |   |  |   | <b>6,329,314.00</b>          |

Gjate periudhes planifikuese 2016-2018, ne bashkefinansim me donatoret, kompania parashikon investime ne infrasktruktur dhe joinfrastruktur ne vlere financiare prei 6,329,314.00EUR, ku nga keto pjesa me e madhe e ketyre investimeve do te shkoj ne rrjetin e ujesjellesit dhe permiresimin e furnizimit me uje te pijes per tere banoret dhe qytetaret komuneave qe kompania ka ne zonen e operimit.



## 5. PLANI OPERACIONAL

Operimi dhe mirëmbajtja e komplet sistemit furnizues me ujë dhe largimi i ujërave të zeza bëhet me një plan operacional.

Plani operacional bazohet në mirëmbajtjen preventive dhe emergjente të tërë sistemit të furnizimit me ujë që nga prodhimi e deri te distribuimi si dhe largimi i ujërave të zeza.

Që kjo ecuri të realizohet në mënyrë të suksesshme nevojitet menaxhim i mirë dhe efikasiteti i stafit në përgjithësi si dhe një planifikim i bazuar në analizat e të dhënave nga raportet e aktiviteteve ndikuese të performancës së kompanisë.

Plani operacional:

Zhvillimi i mapp-ingut në vazhdimësi ,mbledhja, rifreskimi ,përpunimi dhe analizimi i të dhënave nga tereni.

-Mobilizimi i ekipeve intervenuese për sanimin në kohë dhe në mënyrë cilësore të difekteve të mundshme

-Analizimi i kostove të mirëmbajtjes emergjente

-Planifikimi i mirëmbajtjes preventive

-Kooperimi në mes të departamenteve etj.

### 5.1 Programet Operacionale

Menaxhimi i mirë i prodhimit të ujit (sasia dhe cilësia)

Përmirësimi i menaxhimit të riparimeve emergjente

Përmirësimi i aktiviteteve të planifikuara të mirëmbajtjes

Etj.

### 5.2 Programet e performancës mjedisore

Programet e testimit të ujit të pijshëm

Programet e monitorimit të shkarkimit të ujërave të zeza

Etj.

### 5.3 Programet e përgjithshme të administrates

*Zbatimi I kompjuterizimit të gjerë të kompanisë.*

Sa i përket zbatueshmërisë së TIK-ut në kompani mendojmë se jemi në një nivel të knaqëshëm nga që deri tek niveli i pestë i administratës janë të paisur me infrastrukturë përkatëse dhe të gjithë departamentet kanë qasje njëri me tjetrin ky është një avantazh shumë i lart sa i përket koordinimit dhe shmangjes së vonësve mirpo në mënyrë kontinuale bëhet zëvendësimi i paimeve të amorituara(vjetruara) me ato të reja. Ne vitin 2016, investimet që do të planifikohen në fushën e teknologjisë informative është në sistemin GIS I cili system do të mundesojë menaxhimin shumë me efikasitet të rrjetit nëntokësor të ujesjellesit dhe kanalizimit dhe dhe të re fraskturkturen nëntokësore që ka kompania. Planifikimi për punëtorin me GIS është planifikuar që do të fillojë të rekrutohet dhe trajnimi i tij për të funksionalizuar dhe vënë në shërbim të këtij sistemi.

#### 5.3.2 Sistemet të reja të menaxhimit të informacionit dhe të raporteve

Me implementimin e intranetit dhe përtrirjes së softit ku në këtë paket do të hyjë edhe aplikacioni për ankesat e konsumatorëve i cili aplikacion do të krijojë një libër për sejcilin konsumatorë i cili ka bërë ankesat dhe natyrën e tyre njëkohësisht edhe me difektet në terren ku do të kategorizohen në bazë të



prioritetit të defektit me të dhënat e tijë shtesë që mundëson një menaxhim sa më efikas i situatës dhe do të kemi informacione të sakta të cilat më vonë mund të përdoren edhe si një burimi shtesë për përcaktimet e zonave investive, përparsi tjetër është se involvon të gjithë stafin dhe i bënë që të jenë sa më të përgjegjshëm, efikas, monitorues dhe matë performancën e stafit.

### ***5.3.3 Përmirësimet në procedurat e brendshme të kompanisë***

Në vitin e ardhshëm planifikojmë redukimin e procedurave të cilat janë të stërngarkuara ku do të bëhen formate standard për të gjitha departamentet, nxjerrejen e disa rregulloreve të reja me qëllim të përmisimin e cilsisë së shërbimit ndaj konsumatorëve.

### ***5.4 Programi i marrëdhënieve me konsumatorë***

Zyra për marrëdhënie me konsumator ka parapar disa aktivitetet që të mirren lidhur me përmirësin e relacionit kompani konsumatorë.

#### ***5.4.1 Përmirësim në komunikim dhe marrëdhënie me konsumatorë***

Aktivitetet që do të ndërmerren në vitin 2016 janë :

- a) Takim i hapur gjashtmuor me konsumator (ku do të diskutohet dhe të mirren sygjerime)
- b) Takime Face2Face (me të gjithë ata konsumator të cilët nuk bëjnë pagesa të faturave)
- c) Takim me nxënës në shkolla ( me qëllim të njoftimit sa më të mire për rëndësin e ujit)
- d) Informimin e qytetarëve në Radio dhe TV locale (në programet e mëngjesit sa i përket informimit për furnizimit me ujë dhe njoftime eventuale)
- e) Fushat mediale (spote reklamuese në Tv, Radio, Postera, Afishe etj.)
- f) web-faqja (përditësimi i informacioneve dhe qasje në kartelat e tyre personale nga shtëpia)
- g) Hapja e pikave në qytet (do të hapen pika shitje aty ku është koncentrimi më i madh i konsumatorëve njëkohësisht do të bëhet arkëtim dhe informim i qytetarëve). Etj

#### ***5.4.2 Përmirësim në procedurat e faturimit dhe arkëtimit***

Nga që në vitet vijuese parashihet rritja e numërit të konsumatorëve ne do të bëjmë ndarjen e një pjese të lexuesve të cilët do të kenë përgjegjësi leximin e gjendjeve të ujëmatësve si dhe do të bëjmë edhe trajnimin e tyre lidhur me softin e faturimit të cilët pas këtij trajnimi do të jetë e mundur të bëjnë edhe futjen e të dhënave (leximin e ujëmatësve) në system ku do të bëhet e mundur që në kohën e duhur të dërgohen faturat tek konsumatori, sa i përket arkëtimit do të organizojme një trajnim për sjellje ndaj konsumatorit të arkëtuesëve mobil dhe hapjen e pikave tjera arkëtuese në qytet.




## 6. PLANI FINANCIAR

Gjatë viteve 2016-2018 Kompania do të orientohet së paku në mbulimin e shpenzimeve operative me amortizim dhe realizimin e disa prej projekteve kapitale të domosdoshme. Në mënyrë që kompania të jetë e vetëqëndrueshme financiarisht gjatë viteve të ardhshme do të ketë angazhime shtesë që norma e arkëtimit të rritet 70%.

**Tabela nr. 4 – Planifikimi I Faturimit dhe Inkasimit per periudhen 2016-2018**

| Te Dhenat                                    | 2016         | 2017         | 2018         |
|--|--------------|--------------|--------------|
| Faturimi ne EUR                              | 2,254,396.67 | 2,365,029.10 | 2,504,350.81 |
| Inkasimi ne EUR                              | 1,489,893.18 | 1,616,432.06 | 1,745,746.62 |
| % e Planifikuar                              | 66%          | 68%          | 70%          |
| Perqindja e Faturimit - Rritjet gjate viteve | 14%          | 5%           | 6%           |
| Perqindja e Inkasimit - Rritjet gjate viteve | 21%          | 12%          | 11%          |

**Fig. nr. 4 – Prezentimi i Faturimi dhe Inkasimit per periudhen 2016-2018 ne form te grafikur**



Kompania, si ndërmarrje publike që është, me tarifa te rregulluara nga ZRRUK, të gjitha përfitimet financiare do të i'a kthen prapa direkt konsumatorëve të vetë.


Transaksionet e përgjithshme të Kompanisë do të mbahen dhe regjistrohen duke respektuar Standardet e Kontabilitetit Kosovare.

**Tabela nr. 6 – Faturimi ne EUR dhe Inkasimi ne EUR per vitin 2015**

| Te Dhenat   | Janar      | Shkurt     | Mars       | Prill      | Maj        | Qershor    | Korrik     | Gusht      | Shtator    | Tetor      | Nentor     | Dhjetor    | Totali       |
|-------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|--------------|
| Faturimi    | 161,629.12 | 149,591.38 | 163,758.25 | 165,394.79 | 157,327.00 | 159,233.46 | 162,725.95 | 163,292.72 | 162,442.25 | 162,820.00 | 162,851.00 | 162,704.00 | 1,933,769.92 |
| Inkasimi    | 83,840.26  | 84,242.93  | 88,079.07  | 93,952.74  | 94,396.91  | 83,183.57  | 119,540.67 | 133,444.87 | 100,260.00 | 117,748.00 | 117,150.00 | 111,719.00 | 1,227,558.02 |
| e Inkasimit | 52%        | 56%        | 54%        | 57%        | 60%        | 52%        | 73%        | 82%        | 62%        | 72%        | 72%        | 69%        | 63%          |



**Fig nr. 4 - Diagrami Faturimi në € dhe arkëtimi në € (2015)**



Diagrami tregon zvoglimin e hendekut ndërmjet faturimit dhe inkasimit, pra faturimi dhe inkasimi sipas grafikut janë në raport të zhdrejtë mes vetë kësaj zvoglimi i faturimit vjen si angazhim i kompanisë për eliminimin e faturimeve të dyfishta dhe për eliminimin e faturimeve paushalle, në këtë rast me uljen e faturimit rritet inkasimi dhe i afrohen ekuilibrit sidomos në qerekun e fundit të vitit 2015.

Grafiku i planifikimit dhe i inkasimit për periudhën 2014-2016 kemi një rritje të arsyeshme dhe të knaqshme duke marrë parasysh problemet me rrjet, problemet me humbje administrative dhe problemet me edukimin e qytetarëve për pagesën e ujit dhe zhdukje të mitit që uji është i natyrës dhe nuk duhet paguar.

### **6.1 Plani i financimit kapital**

Rreth 90 % e totalit të faturave përllorëriten në bazë të shpenzimit faktik. Kjo përqindje do të rritet krahas projekteve të financuara nga burimet vetenak për ndërrimin dhe riparimin e vazhdueshëm të ujëmatësve dhe rritjen e përgjegjësisë për të matur konsumin.

Menaxhmenti i kompanisë përmes shërbimeve ekzistuese përkatëse mbetet i përkushtuar për lexim me të mirë dhe me korrekt të ujëmatësve konsumatorëve. Në kompani ekziston grupa e Kontrollës ku gjatë gjithë muajit bëjnë kontrollimin e leximeve të bëra nga lexuesit.

Te dhënat financiare për vitin 2016-2018 janë të bashkangjitura në Planin e Biznesit të Kompanisë.

Në vitin 2015 prapë nuk është bërë arkëtimi i mjeteve tona nga fondi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore. Shumë kjo e cila do të na ndihmonte në realizimin e planeve Investive. Presione kemi bërë vazhdimisht që këto mjete tona të realizohen pranë AKP-se. Përveç problemit të mos arkëtitimit të mjeteve nga privatizimi. Ndërmarrja ka rreth 6-8 % raste sociale dhe minoritete ku mirëpresim një kompanizim të mjeteve nga kjo kategori nga ana e Qeverisë njëjtë si është bërë me KEK-un.

Shpenzimet e përgjithshme operative dhe të mirëmbajtjes në vitin 2015 janë në shumë prej **1,459,838.71 EUR** dhe të orientuara në funksionimin normal të Kompanisë dhe të gjitha njësive për qëllim të arritjes së synimeve dhe objektivave të përcaktuara si prioritete.

Këto shpenzime si të tilla mundëson përbushjen e obligimeve dhe zhvillimin normal të Kompanisë. Shpenzimet Operative parashihen të rriten për 12%. Shpenzimet janë pasoje e Inflacionit, rritjes së vazhdueshme të energjisë elektrike, Kemikateve, karburanteve të naftës, mirëmbajtja e pajisjeve dhe rrjetës, shtimit të zonave rurale si dhe rritjes së numrit të punetoreve. Pjesën më të madhe të shpenzimeve e përfshijnë Shpenzimet e Personelit ( përfshin pagat, mëditjet, bonuset, trajnimet ), Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimeve ( përfshin pjesët e vogla për riparim, mirëmbajtja e rrjetit



Kompania rajonale për ujë dhe kanalizim  
 " BIFRUKACIONI " SH.A. Ferizaj

te ujësjellësit dhe kanalizimit, mirëmbajtja e automjeteve etj), Shpenzimet e energjisë elektrike, Shpenzimet e derivateve ( përfshin naftën dhe benzinës për Kompaninë), Shpenzimet e Kemikateve ( përfshin Alumin Sulfatin, Klor i Gazet, Klor i Lënget, Kloruri i Hekurit dhe Karboni Aktiv), si dhe Shpenzimet tjera ( përfshin shpenzimet administrative, regjistrimi dhe sigurimi i automjeteve,taksat per licencim te shërbimeve ZRRUK, taksa e ShUKOS-it, taksa për shfrytëzimin e ujit MMPH, shërbimet nga palët e treta).

Gjatë vitit 2015 Kompania planifikon ti paguajë të gjitha shpenzimet operative për zhvillimin e veprimtarisë normale. Te gjitha shpenzimet jane pa Amortizim dhe borgj te keq, por vetem shpenzimet operztive dhe administrative per zhvillimin e veprimtaris normale te biznesit.Kompania nuk parashikon qe te ete provizionime per borgjin e keq ne vitin 2015.

Ne vazhdim paraqesim ne menyre tabelara shpenzimet e ndodhura per periudhen 2011-2015 dhe ato te planifikuara per periudhen 2016-2018. Siq shihet nga tabela nr. 7, shpenzimet çdo vit kane nje tred te rritjes. Rritja e shpenzimeve per vitin 2016 eshte per arsye te rritjes se shpenzimeve operative me shtimin e zonave rurale qe kompania do te marr nen menaxhim disa sisteme te fshatrave dhe keto do te krijojn shpenzime te energjis elektrike dhe te perpunimit te ujit si dhe ne mirembajtje. Ne tabelen me posht nga viti 2011-2015 jane paraqitur shpenzimet qekane ndodhur, dhe nga vitit 2016-2018 jane shpenzimet e planifikuara sipas aktiviteteve te kompanis per kete periudh qe jane parapar ne kete plan biznesi.


**Tab. Nr. 7 – Shpenzimet e ndoshura dhe ato te planifikuara per periudhen 2011-2018**

| Lloji I Shpenzimeve                         | 2011                | 2012                | 2013                | 2014                | 2015                | 2016                | 2017                | 2018                |
|---|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|
| Pagat e Personelit                          | 488,191.00          | 531,913.00          | 585,366.27          | 734,056.36          | 1,030,600.00        | 1,076,137.93        | 1,136,675.86        | 1,193,136.78        |
| Energjia Elektrike                          | 77,643.00           | 91,792.00           | 94,682.20           | 133,843.62          | 135,749.00          | 231,749.00          | 238,701.47          | 250,636.54          |
| Shpenzimet e Kemikaleve                     | 36,715.00           | 35,264.00           | 40,369.76           | 41,813.43           | 43,485.97           | 46,964.84           | 51,661.33           | 56,827.46           |
| Shpenzimet e qiras                          | -                   | -                   | 5,400.00            | 8,910.00            | 9,000.00            | 9,000.00            | 9,000.00            | 9,000.00            |
| Karburantet                                 | 24,826.00           | 26,094.00           | 23,557.87           | 29,991.61           | 30,891.36           | 32,127.01           | 33,733.36           | 35,420.03           |
| Mardhenjet me Klient (Publik Reklama)       | 10,159.00           | 10,675.00           | 2,030.83            | 4,399.67            | 5,500.00            | 5,720.00            | 6,006.00            | 6,306.30            |
| Shpenzimet administrative                   | 20,676.00           | 14,786.00           | 26,006.81           | 41,660.08           | 35,411.07           | 36,827.51           | 38,668.89           | 40,602.33           |
| Shpenzimet e Mirembajtjes                   | 33,354.00           | 50,603.00           | 90,656.83           | 109,411.59          | 131,293.91          | 150,987.99          | 166,086.79          | 174,391.13          |
| Te Tjera                                    | 24,680.00           | 26,543.00           | 28,091.61           | 43,838.70           | 37,907.41           | 39,423.71           | 41,000.65           | 42,640.68           |
| <b>Totali pa Amortizim</b>                  | <b>716,244.00</b>   | <b>787,670.00</b>   | <b>896,162.18</b>   | <b>1,147,925.06</b> | <b>1,459,838.71</b> | <b>1,628,938.00</b> | <b>1,721,534.36</b> | <b>1,808,961.26</b> |
| Shpenzimet e Borgjit te keq - provizionimet | 291,425.00          | 289,865.00          | 264,911.50          | 286,795.87          |                     |                     |                     |                     |
| Shpenzimet e zhvlersimit                    | 761,768.00          | 793,829.00          | 865,204.53          | 853,632.43          | 870,705.08          | 888,119.18          | 914,762.76          | 923,910.38          |
| <b>Totali meShpenzimet e Amortizimit</b>    | <b>1,769,437.00</b> | <b>1,871,364.00</b> | <b>2,026,278.21</b> | <b>2,288,353.36</b> | <b>2,330,543.79</b> | <b>2,517,057.18</b> | <b>2,636,297.11</b> | <b>2,732,871.65</b> |

Edhe permes grafikur jane prezentuar shpenzimet per periudhen faktike 2011-2015 dhe periudhen planifikuese 2016-2018. Permes grafikur shihet trendi i rritjes se shpenzimeve dhe angazhimi i kompanise per mbajtjen nen kotroll te ketij trendi.



**Fig. nr. 5 – Grafiku i rritjes se shpenzimeve prej vitit 2011 deri ne vitin 2018. Periudha 2016-2018 eshte periudha e plifikimit te shpenzimeve.**




Grafikur me lart paraqet trendin e rritjes se shpenzimeve bashke me shpenzimet e amortizimit per periudhen 2011 deri ne 2015 te cilat shpenzime kane ndodhur dhe ato te planifikuara per periudhen 2016-2018.

**Tab. 8 Te Hyrat dhe Shpenzimet Operative (2007-2018) – Trendi i Ecuris se shpenzimeve dhe te Hyrave**

| Vitet | Te Hyrat     | Shpenzimet   | Fitimi / Humbja e Vitit | Fitimi / Humbja e bartura |               |
|-------|--------------|--------------|-------------------------|---------------------------|---------------|
| 2007  | 927,350.80   | 1,421,635.33 | (494,284.53)            | (1,075,668.00)            | Te Realizuara |
| 2008  | 1,161,604.10 | 2,060,847.07 | (899,242.97)            | (1,974,910.97)            |               |
| 2009  | 1,161,884.22 | 1,752,403.05 | (590,518.83)            | (2,565,429.80)            |               |
| 2010  | 1,363,953.21 | 1,756,152.16 | (392,198.95)            | (2,957,628.75)            |               |
| 2011  | 1,377,223.05 | 1,769,437.00 | (392,213.95)            | (3,349,842.70)            |               |
| 2012  | 1,629,365.42 | 1,871,364.00 | (241,998.58)            | (3,591,841.28)            |               |
| 2013  | 1,811,042.60 | 2,026,278.21 | (215,235.61)            | (3,807,076.89)            |               |
| 2014  | 2,164,765.45 | 2,288,353.36 | (123,587.91)            | (3,930,664.80)            |               |
| 2015  | 2,325,074.14 | 2,330,543.79 | (5,469.65)              | (3,936,134.45)            |               |
| 2016  | 2,595,336.58 | 2,517,057.18 | 78,279.40               | (3,857,855.05)            |               |
| 2017  | 2,740,004.17 | 2,636,297.11 | 103,707.06              | (3,754,147.99)            |               |
| 2018  | 2,845,331.82 | 2,732,871.65 | 112,460.18              | (3,641,687.81)            |               |

**Fig 6. Trendi i te hyrave dhe shpenzimeve 2007 -2018**



Ne grafikun me lart verehet nje rritje e leht e te hyrave ne raport me shpenzimet ne vitin 2017, pra qe te hyrat e planifikuara tejkalojn shpenzimet e planifikuara. Rritja e ketyre te hyrave eshte per dis arsye:

- Regjistrimi i konsumatoreve te ri ne zonen rurale rreth 1700 konsumator te rri,
- Zvoglimi i humbjeve teknike dhe administrative,
- Investimet ne permiresimin e infrastruktures qe parashien te realizohen

Grafiku paraqet te dhenat tabelare ku ne vitin 2017 parashikohet qe te hyrat te tejkalojn shpenzimet dhe kompania te operoj me fitim ne vitin 2017.

**Tab.9 Planifikimi i Arkëtimeve dhe Shpenzimeve në € (2016-2018)**


| Vitet | Te Hyrat     | Shpenzimet   | Fitimi     | Perqindja |
|-------|--------------|--------------|------------|-----------|
| 2016  | 2,595,336.58 | 2,517,057.18 | 78,279.40  | 103.11%   |
| 2017  | 2,740,004.17 | 2,636,297.11 | 103,707.06 | 103.93%   |
| 2018  | 2,845,331.82 | 2,732,871.65 | 112,460.18 | 104.12%   |

Tabela paraqet qe ne vitin 2016 te hyrat te tejkalojn per 3.11% shpenzimet e pergjithshme dhe kompania eshte angazhuar qe te percjell trendin e shpenzimeve dhe te angazhohet ne rritjen e te hyrave, duke mbajtur nen kontroll shpenzimet ne kufirin minimal per periodhen 2016-2018. Ne vitin 2017 kompania planifikon qe te kete nje permiresim te te hyrave duke tejkaluar shpenzimet per 3.93 %, dhe po ashtu edhe ne vitin 2018 te hyrat tejkalojn shpenzimet per 4.12 %. Siq shihet nga tabela dhe nga grafiku, kompania BIFURKACIONI nga viti 2016 fillon te operoj me fitime simbolike, pa me fitimi te vogal dhe dalja nga periodha kur edhe eshte raportuar me humbje aktiviteti i kompanise.





**Fig 7. Planifikimi i te hyrave dhe shpenzimeve në EUR per periudhen (2016-2018)**



## 7. PLANI KOMERCIAL

Parashikohet se në vitin 2016 të bëjmë riorganizimin e inkasanteve, lexuesve dhe ekipeve të shkytyjes për fushatë vëdijesimi dhe edukimi të konsumatoreve për eëndesin e ujit dhe kujdesit ndaj shpenzimeve të ujen në mënyrë racionale.

### 7.1 Rregullimi i lidhjeve ilegale/fantazem/.

Një prej aktiviteteve të zhvilluar edhe më heret ka qenë identifikimi i kycjeve ilegale dhe passive po për vitet në vijim do të jetë me një intensitet edhe më të madh duke angazhuar ekipin e hartave, ekipin për verifikimin e rrjetit si dhe me inkasantët.

### 7.2 Përmirësimi i faturimit të bazës së konsumatorëve

Sa i përket faturimit kompania është duke nxjerr një rregullore mbi faturimin paushall ku do të bëhet ndarja në kategori të caktuar dhe tarifë të caktuar njëherit rifreskimin e bazës së konsumatorëve presim ta bëjmë në gjysmën e vitit vijues së bashku me ekipet e Mapp-ingut,

Punuar nga Menaxhmenti i KRU" BIFURKACIONI" SHA – Ferizaj  
Periudha e planifikimit 2016-2018.

Dhjetor 2015

Punuar:

**Nazif Asllani**  
U.D. Kryeshefit Ekzekutiv

Aprovuar nga Bordi i Drejtoreve

**Faruk Lipovica**  
Kryesuesi i Bordit të Drejtoreve